

VENDIM
Nr. 822, datë 22.11.2017

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 420, DATË 8.6.2016, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E CEREMONIALIT SHTETËROR TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 17, të ligjit nr. 23/2015, “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, dhe të nenit 9, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 420, datë 8.6.2016, të Këshillit të Ministrave, në kapitullin VI, pas nënpikës 6.4, të pikës 6, “Festat zyrtare, ditë përkujtimore dhe ditë të tjera, të shënuara”, shtohet nënpika 6.5, me këtë përmbajtje:

“6.5. Realizimi i dekorit të godinave të ministrive me rastin e festave zyrtare, të parashikuara në nënpikën 6.2., të këtij kapitulli, të bëhet nga Bashkia Tiranë, bazuar në kërkesat e ministrive. Marrëdhëniet ndërmjet ministrive dhe Bashkisë Tiranë për realizimin e dekorit të ministrive rregullohen me udhëzim të ministrit të Financave dhe Ekonomisë.”.

2. Ngarkohen ministritë dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama